




Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



RREGULLORE

RREGULLORE PËR TAKSAT KOMUNALE PËR VITIN 2023

HANI I ELEZIT
2023



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.1, 12.2 (c), 40.2 (a) dhe (g), Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 neni 8, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 47, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15 shkronja (f), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2023 miratoi :

RREGULLOREN PËR TAKSAT KOMUNALE PËR VITIN 2023

Kapitulli I

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen lartësia e taksave komunale dhe shërbimeve të tjera komunale të cilat u ofrohen qytetarëve dhe bizneseve në territorin e Komunës.

Neni 2

Sipas kësaj rregullore, Komuna mund të vjelë të gjitha të hyrat në bazë të taksave.

Neni 3

Kjo rregullore përcakton në veçanti për secilën taksë detyrat dhe obligimet e çdo drejtorie dhe shërbimet së bashku me lartësinë dhe mënyrën e pagesës.

Neni 4

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Kapitulli II: Taksat

Pjesa 1 : Certifikatat

Nr. i taksës	Përshkrimi	Vlera e propozuar	
		Lartësia e taksës për përdorim të brendshëm €	Lartësia e taksës për përdorim të jashtëm €
	Dokumentet zyrtare		
4.1	Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile	0.50€	1.00 €
4.2	Certifikatat e lindjes	0.50€	1.00 €
4.3	Certifikatat e vdekjes	0.50€	1.00 €
4.4	Certifikatat e martesës	0.50€	1.00 €
4.5	Certifikatat e vendbanimit	1.00 €	2.00 €
4.6	Certifikata e e gjendjes martesore	1.00 €	2.00 €
4.7	Certifikata e shtetësisë	1.00 €	2.00 €

4.8	Deklaratë e bashkësisë familjare	1.00 €	4.00 €
4.9	Dokumentet zyrtare për aplikim online (Ekstrakt nga regjistri qëndror i lindjes, Certifikatat e lindjes, Certifikatat e vdekjes, Certifikatat e martesës, Certifikatat e Vendbanimit, Certifikata e gjendjes martesore, Certifikata e shtetësisë, Deklaratë për bashkësinë familjare, Vërtetim nga Arkivi).	1.00 €	2.00 €

	Dokumentet e konfirmuara	Lartësia e taksës €
4.10	Regjistrimi i mëvonshëm të lindjeve në librat e gjendjes civile	20.00
4.11	Regjistrimi i mëvonshëm të vdekjeve në librat e gjendjes civile	50.00
4.12	Vërtetimi mbi lajmërimin - çlajmërimin e vendbanimit	2.00 €
4.13	Vërtetim i të mirave materiale	10.00 €
4.14	Dërgimi i dokumenteve brenda Kosovës përmes faxit zyrtar (një faqe)	1.00 €
4.15	Dërgimi i dokumenteve jashtë Kosovës përmes faxit zyrtar (një faqe)	2.00 €
4.16	Ndërrimi i emrit apo i mbiemrit	20.00 €
4.17	Për konfirmim të statusit martesor	5.00 €
4.18	Deklaratë e bashkësisë familjare (Për studente pa pagesë)	1.0 €
4.19	Përpilimi dhe lëshimi i Aktvdekjes	5.00 €
4.20	Lëshimi i certifikatës mbi vendqëndrimin	2.00 €
4.21	Vërtetim që personi i caktuar nuk është banor i Hanit të Elezit	2.00 €
4.22	Gjetja – sigurimi i dokumenteve në arkivin e Komunës	2.00 €
4.23	Kërkesë për fitimin e shtetësisë	10.00 €
4.24	Kërkesë për lirim nga shtetësia	10.00 €
4.25	Ri-regjistrimet në regjistri i lindjes, regjistri i vdekjes dhe regjistri i martesës, sipas vendimit të organit kompetent dhe sipas dokumentacionit të posaçëm (edhe nga bota e jashtme)	Pa pagesë
4.26	Vërtetimi i certifikatës me fotografi	2.00
4.27	Vërtetim nga Arkivi	1.00 €
4.28	Procesverbal mbi pranimin e atësisë-amësisë	1.00 €
4.29	Anulim i regjistrimit të lindjeve të regjistruara dyfish	5.00 €
4.30	Dëshmi vdekje	2.00 €

	Taksa për ceremoni martesore	
4.31	Lidhja e kurorëzimit jashtë objektit të Administratës Komunale	10.00 €
4.32	Për kurorëzimet të cilat bëhen jashtë orarit të punës dhe festave në SHCK-së	50.00 €
		100.00 €

	Vërtetim i dokumenteve zyrtare	Lartësia e taksës €
4.33	Vërtetimi zyrtar, përshkrimeve dhe fotokopje (1 faqe me tekst)	1.00 €
4.34	Kopjet e vërtetuara të autorizimeve, lejeve dhe licencave	2.00 €

	Taksat nga zyra e prokurimit	Lartësia e taksës €
4.35	Kërkesa për referencë nga prokurimi	5.00 €
4.36	Fotokopje të dosjeve të tenderit për aktivitet të prokurimit	2.00€/faqe

Neni 5

Zyrtarët nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme janë përgjegjës për këto shërbime dhe mbetet për obligim që zyrtarët e autorizuar (Qendra për Shërbim Qytetarëve) të bëjnë vjeljen, lëshimin e dëftesave dhe dorëzimin e pagesave në fund të orarit të punës Zyrtarit të Hyrave vetanake të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, kurse zyrtari i të hyrave pas barazimit me zyrtarin e zyrës së pritjes bënë dorëzimin në xhirollogarinë e komunës.

Neni 6

Me prezantimin e dokumentit të dëshmisë, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, invalidët e luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, veteranët e luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, anëtarët e ngushtë të familjeve të viktimave civile të luftës, personat me aftësi të kufizuara dhe personat që realizojnë ndihma sociale në Qendrën për Punë Sociale, këto kategori lirohen nga pagesa e të gjitha shërbimeve nga neni 4.1 deri neni 7.1 (përfshirë 4.3.1. dhe 4.3.2) të kësaj rregullore.

Neni 7

	Shërbimi i arkivit	Lartësia e taksës €
7.1	Për gjetjen e lëndës në arkiv pas vitit 2005	5.00 €
7.2	Kopje të projekteve individuale dhe tjera, për çdo faqe të formatit A4	0.20 €
7.3	Kopje të projektit për çdo faqe të formatit A3	0.50 €
7.4	Vërtetimet e diplomave, në mungesë të noterit territorial	1.00 €

Neni 8

	Taksa për qasje në dokumente publike	Lartësia e taksës €
8.1	Fotokopja për një faqe (A4) me ngjyra	0,20 €
8.2	Fotokopja për një faqe (A4) bardhë e zi	0,04 €
8.3	Fotokopja për një faqe (A3) me ngjyra	0,50 €
8.4	Fotokopja për një faqe (A3) bardhë e zi	0,10 €
8.5	Shtypi për një faqe (A4) me ngjyra	0,20 €
8.6	Shtypi për një faqe (A4) bardhë e zi	0,04 €
8.7	Shtypi për një faqe (A3) me ngjyra	0,50 €
8.8	Shtypi për një faqe (A3) bardhë e zi	0,10 €
8.9	Dokumentet e incizuara në CD/DVD	0,60 €
8.10	Audio incizimi – 1,60 Euro për audio-kasetë dhe 0,25 Euro për çdo minutë të incizimit	

Neni 9

DREJTORIA PËR ARSIM KULTURË RINI DHE SPORT

Pjesa 2

Ligji mbi edukimin parashkollor (Ligji nr. 02/L-52), Neni 18, neni 22.

9.1	Taksë mujore për një fëmijë në çerdhe	30.00€
9.2	Taksë për dy fëmijë	50.00€
9.3	Taksë për fëmijën e tretë e më shumë	(Falas)

Udhëzimi administrativ 03/2013 lëshimi i dokumenteve dublikatë nga institucionet edukative-arsimore dhe universitare.

9.4	Dëftesa dublikatë	1 €
9.5	Diploma dublikatë	1 €

Udhëzimi Administrativ 01/2017 për participimin e vijuesve të arsimit dhe aftësimit për të rritur.

9.6	Për regjistrimin e vitit (për një klase 100 €)	100 €
9.7	Për praktik profesionale	50 €
9.8	Për Provim diferencial	10 €
9.9	Për provimet përfundimtare të klasës, certifikatën dhe diplomën	50 €

Udhëzim Administrativ 21/2014 përfundimi i shkollimit për nxënësit e vitit të fundit të arsimit të mesëm të ultë(klasa 9-të) dhe arsimit të mesëm të lartë (klasa 12/13) dhe/ose diploma.

Taksa për shfrytëzimin e sallës së kulturës

9.10	Salla e sporteve për orë	
	Gjatë ditës	5.00€
	Gjatë natës	10.00€
	Për aktivitete komerciale	50.00€
9.11	Fushat e sportit (të Hapura) për orë	
	Gjatë ditës	3.00€
	Gjatë natës	5.00€
9.12	Salla e shtëpisë së kulturës për orë	20.00€

Lirohen nga këto taksa organizatat jofitimprurëse.

Neni 10

DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTËR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Pjesa 3

Çmimorja e shërbimeve komunale kadastrale

Udhëzim Administrativ nr.11/2019 për ndarjen e ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës dhe 12/2019 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës kadastrale të ofruara nga zyrat kadastrale komunale dhe kompanitë gjeodete të licencuara. Për çmimet e produkteve kadastrale të kompanive gjeodezike, nga drejtoria përkatëse, zbatohen udhëzimet administrative 11/2019 dhe 12/2019

Nr.i Taksës	Kategoria	Vlera €
Ndërrimi i kulturave të parcelave		
10.1	Ndërrimi i kulturës të një parcele pa matje gjeodezike	10.00 €
Ndarja e Parcelave		
10.2	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe deri 0.50 ha	80.00 €, për një njësi
10.3	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 0.50 ha der 1 ha	90.00 €, për njësi
10.4	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 1 ha deri 2.5 ha	120.00 €,për njësi
10.5	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 2.5 ha deri 5 ha	140.00 €, për njësi
10.6	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 5 ha deri 10 ha	170.00 €,për njësi
10.7	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 10 ha	300.00 €, për njësi
10.8	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës në zona urbane sipas planit urbanistik	150.00 €,për njësi
Bashkimi i parcelave		
10.9	Krijimi i një parcele të re nga procesi i bashkimit të dy parcelave	80.00 €
10.10	Për çdo parcelë tjetër në kufi	35 €
10.11	Krijimi i një parcele të re nga procesi i bashkimit të dy parcelave në zona urbane sipas planit urbanistik	150 €
10.12	Për çdo parcele tjetër në kufi	70.00 €
Matja e ndërtesave		
10.13	Matja e bazamentit të ndërtesave individuale (shtëpi banimi) deri 100 m ²	100 €
10.14	Matja e bazamentit të ndërtesave individuale (shtëpi banimi) mbi 100 m ²	1.00 €, për m ²
10.15	Matja e bazamentit të ndërtesave të kolektiv	1.20 €,për m ²
10.16	Matja e bazamentit të ndërtesave banesore /afariste	1.50 €,për m ²
10.17	Matja e bazamentit të ndërtesave qeveritare dhe publike	1.00 €, për m ²
10.18	Matja e bazamentit të ndërtesave sportive (stadiume,halla sportive etj)	1.00 €,për m ²
10.19	Matja e bazamentit të ndërtesave kulturore dhe fetare	0.50 €,për m ²
Matja e pjesëve të ndërtesave		
10.20	Matja dhe përpilimi i skicave të njësisve banesore , si dhe hapësirat e përbashkëta deri në 75 m ²	80 €

10.21	Matja dhe përpilimi i skicave të njësive banesore , si dhe hapësirat e përbashkëta mbi Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura) 75 m ²	1.20 € m ²
10.22	Ndarja e hapësirave të njësive afariste si dhe hapësirat e përbashkëta deri në 75 m ²	110 € për njësi
10.23	Ndarja e hapësirave të njësive afariste si dhe hapësirat e përbashkëta mbi 75 m ²	1.50 € për m ²
Matjet e përvojave		
10.24	Matja e përvojave nëntoksore dhe përpilimi i elaboratit me të gjitha atributet deri në 100 m gjatësi	130 €
10.25	Matja e përvojave nëntoksore dhe përpilimi i elaboratit me të gjitha atributet mbi 100 m	1.50 €,për m gjatësi
10.26	Matja e përvojave mbitoksore dhe përpilimi i elaboratit me të gjitha atributet deri në 100 m gjatësi	100.00 €
10.27	Matja e përvojave mbitoksore dhe përpilimi i elaboratit me të gjitha atributet mbi 100 m gjatësi	1.00 €,për m gjatësi
10.28	Matja e përvojave nëntoksore dhe përpilimi i elaboratit me të gjitha atributet	3.00 €,për m ²
10.29	Matja e tuneleve dhe përpilimi i elaboratit me të gjitha atributet	8 €,për m ²
Përcaktimi i kufijve të parcelave		
10.30	Për një parcelë me sipërfaqe deri në 0.50 ha -për një njësi	130.00 €
10.31	Për një parcelë me sipërfaqe mbi 0.50 ha deri 1.00 ha -për një njësi	180.00 €
10.32	Për një parcelë me sipërfaqe mbi 1 ha deri 2.5 ha -për një njësi	220.00 €
10.33	Për një parcelë me sipërfaqe mbi 2.5 ha deri 5 ha -për një njësi	330.00 €
10.34	Për çdo hektar tjetër	100€
10.35	Për një parcelë urbane sipas planit urbanistik	300€
Ri - rregullimi i kufijve të parcelave		
10.36	Për një parcele me sipërfaqe deri në 0.50 ha	80.00 €
10.37	Për sipërfaqe prej 0.50 ha deri 1.00 ha	100.00 €
10.38	Për çdo hektar tjetër mbi një hektar	100.00 €
Punët e veçanta gjeodezike		
10.39	Bartja - piktimi në terren i të dhënave nga planet urbanistike për objekt individual	1.00 €, për m ²
10.40	Bartja - piktimi në terren i të dhënave nga planet urbanistike për objekte banimi kolektiv apo afarist	1.50 €, për m ²
10.41	Identifikimi i njësive kadastrale në zyrë	10 €
10.42	Identifikimi i njësive kadastrale në terren	30 €
10.43	Konsuluta Profesionale	10 € për një orë
Dhënia e informatave nga sistemi i informacioneve kadastrale të tokave të Kosovës nga ZKK		
10.44	Vërtetimet e ndryshme	3 €
10.45	Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura)	4 €
10.46	Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura)	20 €
10.47	Kopja e planit	4 €
10.48	Kopje në formatin A3 me ortofoto (bardhë e zi) – katër euro	4 €
10.49	Kopje në formatin A3 me ortofoto (kolor) – pesë euro	5 €
10.50	Historiati për një njësi kadastrale – njëzet euro	20 €

Baza Gjeodezike		
Pikat Trigonometrike:		
10.51	Koordinatat Y, X, me përshkrim	5.00 €
Pikat Lidhëse:		
10.52	Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	4.00 €
Pikat Poligonale:		
10.53	Koordinatat Y, X, H me përshkrim	3.00 €
Pikat Reper:		
10.54	Koordinatat Y, X, H me përshkrim	5.00 €
Pikat në linjë		
10.55	Koordinatat Y, X, H	2.00 €
Pikat e detajit		
10.56	Koordinatat Y, X	1.00 €
Tarifat për të dhënat në formën digjitale		
10.57	Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) deri në 1 ha- për njësi.	10 €
10.58	Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 1ha deri 2 ha- për njësi.	20 €
10.59	Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 2.01ha deri 5 ha- për njësi.	40 €
10.60	Parcela në format digjital (shpfile,dëg, gml, ili) mbi 5 ha- për njësi.	60 €
10.61	CD—kompakt disku zero euro e pesëdhjetë cent	0.50 €
Regjistrimi pronësisë, posedimit, në bazë të transaksioneve (shitblerjes)		
<ul style="list-style-type: none"> • UDHEZIMI ADMINISTRATIV (MEA) NR. 09/2020 PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE PËR REGJISTRIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME, • UDHEZIMI ADMINISTRATIV (MMPH) NR.05/2021 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHEZIMIT (MEA) NR. 09/2020 PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE PËR REGJISTRIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME, 		
Tarifa per regjistrimin e pronesisë sipas vlerës së transaksionit është:		
10.62	Për vlerën e transaksionit deri në 10,000 € paguhet taksa prej:	30.00 €
10.63	Për vlerën e transaksionit prej 10,001 € deri në 50,000 € paguhet taksa prej:	50.00 €
10.64	Për vlerën e transaksionit prej 50,001 € deri në 100,000 € paguhet taksa prej:	70.00 €
10.65	Për vlerën e transaksionit prej 100,001 € deri në 200,000 € paguhet taksa prej:	90.00 €
10.66	Për vlerën e transaksionit prej 200,001 € deri në 500,000 € paguhet taksa prej:	120.00 €
10.67	Për vlerën e transaksionit prej 500,001 € deri në 1,000,000 € paguhet taksa prej:	240.00 €
10.68	Për vlerën e transaksionit mbi 1,000,000 paguhet taksa prej:	500.00 €
10.69	Për vlerën e kontratës – transaksioni që është vërtetuar para vitit 1999 tarifa është	50.00 €
Tarifa e regjistrimit të pronësisë, në bazë të kontratës mbi dhuratën		
10.70	Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së dhurimit për çdo anëtar të ngushtë të familjes është tridhjetë euro (30€)	
10.71	Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së dhurimit për çdo personin që nuk është anëtar i familjes dhe nuk është cekur vlera e pronës tarifa është tetëdhjetë euro (80€)	

Tarifa e Regjistrimit të pronësisë në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përjetshme	
10.72	Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përjetshme për personin që është anëtar i familjes është tridhjetë euro (30€) për çdo pronar
10.73	Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përjetshme për personin që nuk është anëtar i familjes dhe nuk është caktuar vlera e pronës tarifa është 80 euro
Tarifa e Regjistrimit të pronësisë apo të drejtave tjera sendore në bazë të titullit juridik të organeve administrative dhe gjyqësore.	
10.74	Tarifa për regjistrimi e të drejtave mbi pronën e paluajtshme apo të drejtave tjera sendore në bazë të Vendimit të organit administrative apo gjyqësor është 30 euro për çdo pronar.:
Tarifa për regjistrimin e bashkëpronësis apo pronësisë së përbashkët	
10.75	Tarifa për regjistrimin e të drejtës në bashkpronësi apo pronësi të përbashkët për bashkëpronarin apo pronarin e përbashkët është 30 euro
10.76	Tarifa për regjistrimin e të drejtës në pronësi të përbashkët për bashkshortët është 30 euro për një titull juridik
10.77	Tarifa për regjistrimin e njësis kadastrale si pjesë e ndërtesës është 25 euro për njësi
10.78	Tarifa për regjistrimin e njësis kadastrale të krijuar nga ndarja apo bashkimin është 20 euro për njësi
10.79	Lirohet nga tarifa për regjistrimin e pronësis së përbashkët të ndërtesave kolektive në bashkpronësi
10.80	Lirohet nga tarifa për regjistrimin e hapësirave të përbashkta si njësi të veqanta
Tarifa e regjistrimit të ndarjes së bashkpronësis apo pronësis së përbashkët	
10.81	Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndarjes nga bashkpronësia apo pronësia e përbashkët për secilin bashkëpronar që bëhet pronar individual është 30 euro
10.82	Lirohet nga tarifa për regjistrimin e ndarjes nga bashkpronësia sipas nenit 6 parag. 3 dhe 4 i Udhezimit administrativ Nr. 12/19 për Ndarjes dhe Regjistrimin e parcelës.
Tarifa e regjistrimit të pronësisë në bazë të Trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare.	
10.83	Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të Trashëgimisë është 10 euro
10.84	Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të Trashëgimisë e cila rrjedh nga testamenti është 20 euro
10.85	Tarifa për për regjistrimin e pronësisë në bazë të shkëputjes së bashkësis familjare për çdo anëtar të familjes që bëhet pronar është 20 euro
Tarifa e regjistrimit të pronësisë, në bazë të ndërrimit-këmbimit të pronës së paluajtshme.	
10.86	Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndërrimit-këmbimit të pronës së paluajtshme, për secilin pronar është 40 euro
TARIFA PËR REGJISTRIMIN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT – QIRAMBAJTJA	
10.87	Tarifa për regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes për çdo njësi kadastrale kur pronar është qeveria apo komuna me kohë zgjatje deri në 10 vite është 10 euro
10.88	Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit-qirambajtjes për çdo njësi kadastrale kur pronar është qeveria pao komuna, me kohë zgjatje prej 10 vite deri 40 vite është 30 euro

10.89	Tarifa për regjistrimin e te drejtës së shfrytëzimit-qirambajtjes për çdo njësi kadastrale kur pronar është qeveria pao komuna, me kohë zgjatje prej 40 vite deri 99 vite është 50 euro	
10.90	Tarifa për regjistrimin e qiras nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje deri në 10 vite për çdo njësi kadastrale është 10 euro	
10.91	Tarifa për regjistrimin e qiras nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje mbi 10 vite për çdo njësi kadastrale është 20 euro	
10.92	Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit-qirambajtjes për pronat e privatizuara nga ish ndërmarrjet shoqërore me kohë zgjatje prej 99-vite bëhet duke zbatuar tarifën e përcaktuar sipas nenit 5 të këtij udhezimi administrativ.	
TARIFA PËR REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE		
Tarifa për regjistrimin e Hipotekave sipas vlerave të kredive të përcaktuar me dokumentin e hipotekës është:		
10.93	Kërkesa (kredia) në vlerën deri 30,000 € paguhet taksa në shumën prej:	20.00 €
10.94	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 30,001 € - 50,000 € paguhet taksa prej:	30.00 €
10.95	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 50,001 € - 100,000 € paguhet taksa prej:	60.00 €
10.96	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 100,001 € - 200,000€ paguhet taksa – prej:	90.00 €
10.97	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 200,001 € - 500,000€ paguhet taksa – prej:	120.00 €
10.98	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 500,001 € - 1,000,000€ paguhet taksa – prej:	240.00 €
10.99	Mbi vlerën 1,000,000 €, paguhet taksa –prej:	400.00 €
10.100	Hipoteka e cila regjistrohet në dy apo më shumë ZKK, tarifa përpjestohet në mënyrë të barabartë	
TARIFA PËR MODIFIKIMIN DHE FSHIRJEN E HIPOTEKËS		
10.101	Tarifa për modifikimin e hipotekës së regjistruar është :	10.00 €
10.102	Lirohet nga tarifa fshirja e Hipotekës nga Regjistri.	
TARIFA PËR REGJISTRIMIN, MODIFIKIMI DHE FSHIRJA E SERVITUTIT		
10.103	Tarifa për regjistrimin e të drejtës së Servitutit për secilën parcelë dominante apo person është :	30.00 €
10.104	Tarifa për modifikimin e servitutit është :	10.00 €
10.105	Tarifa për fshirjen e Servitutit nga regjistri është :	20.00 €
TARIFA PËR REGJISTRIMIN, MODIFIKIMIN DHE FSHIRJEN E BARRAVE DHE NGARKESAVE TJERA		
10.106	Lirohet nga tarifa regjistrimi i barrës.	
10.107	Lirohet nga tarifa regjistrimi i masës së siguris (masës së përkohshme) apo modifikimin e saj	
10.108	Tarifa për regjistrimin e vërejtjes sipas ligjit për regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme bëhet duke paguar taksën në shumën prej 40 € .	
10.109	Tarifa për regjistrimin e ndalesës nga Përmbartuesi privat apo Gjykata në procedurë përmbartimore për çdo akt juridik është 30 €	
10.110	Tarifa për regjistrimin e vërejtjes së mbajtësit në pronën e paluajtshme të të mbajturit në momentin e lidhjes së kontratës mbi mbajtjen e përvetshme është: 20 €.	
10.111	Lirohet nga tarifa modifikimin i barrës apo ngarkesës tjetër.	

10.112	Lirohet nga tarifa fshirja e barrës apo ngarkesës tjetër.	
Tarifa perKorigjimin e të dhënave kadastrale		
10.113	Tarifa per korigjimin e të dhënave kadastrale që konstatohen që janë regjistruar gabim si pasoj e dokumentacionit të dorzuar nga palët është 30 €.	
10.114	Lirohet nga tarifa per korigjimin e të dhenave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar si pasoj e gabimit të ZKK-s apo AKK-s si dhe të gjitha gabimet e konstatuara nga sistemet e mëparshme	
10.115	Lirohet nga tarifa për korigjimin e numrit identifikues KCID në numrin personal të pronarëve. ZKK është e obliguar që të bëjë korigjimin e numrit identifikues KCID sipas detyrës zyrtare	
Shërbimet Online		
10.116	Për nxjerrjen e certifikatave online është 3 €.	
10.117	Obligohen përdoruesit e institucioneve publike dhe përdoruesit privat të cilët ofrojnë shërbime publike që të bëjnë shenimin në Regjistrin kadastral, për pronën e paluajtshme që është në procedurë ose është përfunduar. shënimi në Regjister bëhet pa pagesë	
REGJISTRIMI I TË DREJTAVE TJERA		
10.118	Regjistrimi i të drejtave tjera mbi pronën e paluajtshme e të cilat nuk janë përfshirë me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ do të regjistrohen	50.00 €
10.119	ZKK është e obliguar qe pas çdo bdryshimi ne Regjister të e pajisë palën me çertifikatë pronësie dhe kopje plani pa pagesë	

Neni 11

11.1. Zyra kadastrale e Komunës kryen punë kadastrale të terrenit vetëm për interes publik me kërkesë të komunës.

11.2. Me prezantimin e dokumenteve të dëshmisë, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, invalidët e luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, veteranët e luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, anëtarët e ngushtë të familjeve të viktimave civile të luftës, personat me aftësi të kufizuar dhe personat që realizojnë ndihma sociale me këtë rregullore do të lirohen nga pagesa e taksave nga neni 10 pika 10.45, 10.46 dhe 10.47 të kësaj rregullore.

Pjesa 4 Taksat për Urbanizëm

Neni 12

Taksa për leje ndërtimore dhe rregullimi të tokës ndërtimore		
12.1	Ndërtimet e kategorisë I dhe II (për m ²):	1.00 €
12.2	Legalizimi i ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe ndërtimëve pa leje të kategorisë II që janë shtëpi (m ²)	1.00 €
12.3	Ndërtimet e kategorisë II të cilat nuk janë shtëpi (m ²)	2.00€
12.4	Ndërhyrjet në ndërtime me leje	2.00€
12.5	Pompat e benzinës (për m ³ të kapacitetit të rezervarëve të derivateve)	30.00 €

12.6	Fushat e përkohshme sportive	300.00 €
12.7	Vendosja e antenave – transmetuesve si telefonisë, celulare, fikse, internetit .	300.00 €
12.9	Për pishinat verore për m ²	2.00 €
12.10	Për bazene për kultivim të llojeve të ndryshme të peshqve për m ²	2.00 €
12.11	Për shndërrimi e lokaleve banesore në lokale afariste (ndërrim i destinacionit në sektorin privat apo shtetërore për m ²)	1.00 €
12.12	Mbi ndërtimi dhe shndërrimi i hapësirave të përbashkëta në banim	1.00 €
12.13	Taksa rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës (për m ² /kokë banori)	87.40 €
12.14	Rezervuar (sillosat) për material ndërtimor (m ³)	10.00€

Vërejtje:

1. Me prezantimin e dokumentacionit valid të dëshmisë, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, shtëpitë e ndertuara humanitare lirohen nga neni 12.1.1 pagesat për leje ndertimi të objekteve individuale të banimit.
2. Bazuar në nenin 20 të Ligjit për Legalizim nr. 06/L- 024 nga taksa për legalizim do të lirohen:
 - a) Ndertimet e ndertuara për interes publik, me leje të një autoriteti përkatës publik ose me financim të qeverisë.
 - b) Ndertimet e rindërtuara si rezultat i luftës, konfliktit, trazirave shoqërore ose forcës madhore.
 - c) Ndertimet pa leje në pronsi të përfituesve të skemës së ndihmës sociale dhe të cilët paraqesin kartelën e ndihmës sociale të vlefshme.
 - d) Ndertimet e identifikuara në ortofoton zyrtare të vitit 2004

12.15	Qiraja në pronësi të lokaleve pronë e K.K. Hani i Elezit, (për m²/ muaj):	
	Sipërfaqja deri në 50 m ²	1.00 €
	Sipërfaqja nga 51 deri në 100 m ²	0.70 €
	Sipërfaqja me mbi 100 m ²	0.50 €
12.16	Sipërfaqet ndihmëse të lokaleve (kuzhinat, depot etj)	0.30 €
12.17	Qiraja për shfrytëzimin e gypave nëntokësor taksë vjetore për metër gjatësi 0.30€	
12.18	Qiraja për shfrytëzimin e tokës, pronë e komunës për biznes	
12.19	Objektet e përkohshme (për m² / muaj):	
	Zona I	0.60 €
	Zona II	0.50 €
	Zona III	0.40 €
	Zona IV	0.30 €
Qiraja sipas pikës 12.3.1. vlen për katin përdhes. Për katet tjera vlera e qirasë llogaritet sa 50% e qirasë për katin përdhes.		

12.20 Taks për shfrytëzimin të hapsirës para objekti afarist (vendosja e teraces) 50% nga vlera e qirasë.	
Vërejtje: Përgjatë rrugëve magjistrale dhe rajonale qiraja për shfrytëzimin e tokës pronë e Komunës për qëllime biznesi është sikurse në zonën I – e parë.	
12.21	Qiraja për shfrytëzim të tokës ndërtimore për banim dhe destinim tjetër (Për m ² / në vit)
	Për banim 0.50 €
	Për garazha 2.00 €
	Për destinim tjetër – Parkim 2.00 €
12.22	Qiraja për dhënien në shfrytëzim të objektit për banim-prone Komunale m ² /muaj 0.15 €

Këto taksa vlejné për pronat e dhëna në shfrytëzim më herët ndërsa për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale kjo bëhet sipas ligjit 04-L-144

12.23	Për daljen në teren sipas kërkesave	10.00 €
12.24	Pagesa për leje rrënimi	10.00€
12.25	Për dhënien e Pëlqimeve të ndryshme	10.00 €
12.26	Lëshimi i vërtetimeve të ndryshme	1.00€
12.27	Pagesa për aplikim për leje përdorimi	5.00 €
12.28	Lëshim i vërtetimit mbi shkallën e dëmtimit	1.00 €

Neni 13

Masat ndëshkuese apo dënimet të cilat duhet t'i zbatoj zyrtari i deleguar, përkatësisht Inspektorati janë të përcaktuara në këtë rregullore, gjegjësisht nga neni 27 i kësaj rregulloreje.

Neni 14

Taksat për dhënien e lejes mjedisore komunale

Në bazë të UA nr.01/2017 Taksën për tu pajisur me LMK aplikuesi duhet të paguaj, për projektet:

Në vlerën investive të projektit deri 25,000 € paguhet tarifa në vler prej (50 €);

Në vleren investive të projektit deri mbi 25,000€ paguhet tarifa 0.2% të vlerës investive të projektit.

Projektet që i nënshtrohen Lejes Mjedisore

1. Autoserviset.
2. Autolarjet.
3. Autoserviset me automjete jashtë pordorimit deri në 20 copë.
4. Stacionet e karburantëve të gasit (GLN) deri 5m³.
5. Stacionet e karburantëve me kapacite deri 50m³.
6. Sharrë për lënd drunore.
7. Fabrika për përpunim druri,mobilieri,tapiceri deri 1000m³/vit.
8. Furrat për prodhim të bukës dhe produkteve të miellit.
9. Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit dhe ujrave të zeza në gjatësi deri 5km.
10. Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrjetit të ujësjellsit në gjatësi deri 5 km.
11. Riparimi i rrugëve urbane egzistuse dhe ndërtimi i aksëve të reja rrugore (me gjatësi deri 5km).
12. Mishtoret.
13. Prodhimi i gëlqeres së shuar.
14. Prodhimi i betonit dhe elementeve parafabrikate, pllakave etj. Me kapacitet të projektuar deri në 2 m³ beton/ orë.

15. Qendra për grumbullimin e mbeturinave nga ndertimi dhe demolimit, për komunat të cilat kanë më pak se 60,000 banorë.
16. Rritja artificiale e peshkut në hurdha, me sipërfaqe deri në 300 m².
17. Pishinat, pa objekte hotiliere dhe objekteve përcjellse.
18. Punishtet për përpunim të mermerit.
19. Ndërtimi i objekteve të banimit kolektiv dhe të shërbimëve (hoteliere, tregtare, komerciale, afariste etj) me sipërfaqe bazë mbi 450m² ose në sipërfaqen totale të objektit mbi 1,500m²
20. Vepromtaria e prodhimit të kompostit, me sasi totale përpunimi deri 100m³ ose 40 ton/vit.
21. Depoja për plehëra kimike dhe pesticide.
22. Objekte shërbyse për ushqime (qebabto, ëmbëltore, gjellto, restorante etj).
23. Vendet apo qendrat për mbledhjen dhe grumbullim të mbeturinave, ku magazinohen mbeturinat inerte (plastikë, letër dhe qelq), në sasi deri 30 ton.
24. Impiantet për rritjen intenzive të shpenzëve, bagtive të imta dhe të mëdha që kanë më pak se: 5,000 shpend; 250 derra; 50 gjedha; 500 bageti të imta.
25. Paisjet për shfrytëzimin e fuqisë së erës për prodhimin e energjisë, me fqj instaluse deri 100Kw/orë.
26. Sistemet solare me sistemet fotovoltaike të prodhimit të energjisë/ avullit, deri 100Kw/ orë
27. Stacionet e telefonis mobile.
28. Vendet e tregimit të kafshëve në vende të hapura dhe mbyllura.
29. Pikat e magazinimit dhe tregimit të materialeve të ndertimit.
30. Qendra zeytare.
31. Serviset (servisimi i paisjeve teknike dhe elektronike).
32. Studiot fotografike.
33. Prodhimi i dyerve dhe dritarëve të plastikës.

Projektet që lirohen nga Leja Mjedisore

Projektet publike:

1. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitimet e tyre në gjatësi deri 5 km
2. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitim i ujësjellësve ekzistues në gjatësi deri 5 km
3. Riparimi i rrugëve urbane egzistuese dhe ndertimi i aksëve rrugore (me gjatësi deri 5km)

Neni 15

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Pjesa 5: TAKSAT NGA USHTRIMI I VEPRIMTARIVE AFARISTE

Taksat në zeytari

Veprimtaritë punuese		
15.1	Ortarët	Lirohen
15.2	Rrobaqepësit	Lirohen
15.3	Këpucëtarët	Lirohen
15.4	Argjendarët	80.00€
15.5	Bukëpjekësit	80.00€
15.6	Frizerët për meshkuj (rrojtarët)	48.00€

15.7	Floktarët për femra (frizeret)	60.00€
15.8	Automekanikët	60.00€
15.9	Autoelektricit	60.00€
15.10	Autollaker	60.00€
15.11	Gomisteritë	32.00€
15.12	Auto larjet	40.00€
15.13	Serviset e pajisjeve të amvisërisë	32.00 €
15.14	Xhamaprerësit	40.00 €
15.15	Fotografistët	Lirohen
15.16	Përpunues të llamarinës (Teneqepunuesit)	40.00 €
15.17	Punëtoritë të cilat merren me prodhimin e dyerve dhe dritareve	80.00 €
15.18	Shitoret tregtare të aparateve elektrike, teknikës së bardhë dhe aparateve të TV	80.00 €
15.19	Shitoret tregtare të kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera informative	80.00 €
15.20	Shitoret tregtare të plastikës	48.00 €
15.21	Shitore tregtare me produkte sanitare dhe elektrike	48.00 €
15.22	Ndërmarrjet që merren me shitjen e duhanit	100.00 €
15.23	Tregti me shumicë dhe pakicë e kafes, çait, kakaosë dhe erëzave	25.00€
